



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency



Ref.: 594/25 Datë: 27.05.2025

Në mbështetje të nenit 11 të Ligjit nr. 08/I-110 për Agjencinë e Kosovës për Akreditim (GZ.nr. 13 / 29 qershor 2023, Prishtinë, nenit 7 të Ligjit për Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-037 (GZ, Nr.14/9 Shtator 2011), Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative Nr.05/L-031 (GZ.Nr.20/12 Qershor 2016), Udhëzimi Administrativ (MASHTI) Nr. 01B-03/2024 për vlerësimin e përshtatshmërisë së bartësve të programeve, Rregullorja (AKA) Nr. 04/2024 për Manualin e Akreditimit/Riakreditimit dhe Validimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe Programeve të Studimit në Nivelin Bachelor dhe Master, Rregulloren e Punës së Këshillit Shtetëror të Cilësisë, si dhe procesverbalit të mbledhjes 137 të mbajtur më 19.05.2025, mori:

V E N D I M

- I. Riakreditohet programi i studimit të Fakultetit të Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike në Universitetin e Prishtinës për periudhën tre (3) vjeçare, (1 tetor 2025 – 30 shtator 2028):
 - *Elektroenergjetikë, BSc 180 ECTS, me kuotën maksimumi 60 studentë për vit akademik.*
- II. Akreditohet programi i studimit të Fakultetit të Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike në Universitetin e Prishtinës për periudhën tre (3) vjeçare, (1 tetor 2025 – 30 shtator 2028):
 - *Elektroenergjetika dhe Menaxhimi i Energjisë, MSc 120 ECTS, me kuotën maksimumi 30 studentë për vit akademik.*
- III. Numri i studentëve aplikohet për secilin vit të studimit për periudhën e akreditimit.
- IV. Obligohet Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike në Universitetin e Prishtinës që deri më datë 30.09.2025 të dorëzojë në Agjencinë e Kosovës për Akreditim (tutje AKA) Planin e Implementimit të Rekomandimeve të dhëna nga ekspertët ndërkombëtar të akreditimit.
- V. Obligohet Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike në Universitetin e Prishtinës të raportojë dhe arsyetojë në AKA çdo ndryshim në listën e bartësve të programeve të studimit, brenda 90 ditëve. Ndryshimi i bartësve bëhet vetëm me vendim nga KShC.
- VI. Institucioni i Arsimit të Lartë mban përgjegjësi ligjore për çdo moszbatim apo tejkalim të këtij vendimi.
- VII. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

ARSYETIM

Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike në Universitetin e Prishtinës brenda afatit ligjor ka parashtruar kërkesë në Agjencinë e Kosovës për Akreditim, për riakreditimin e programeve të studimit me stafin akademik si në tabelë:

Nr.	Programi i studimit	Bartësit e programit
1.	<i>Elektroenergjetikë, BSc 180 ECTS (R)</i>	Arben Gjukaj Shqipe Lohaj Nuri Berisha
2.	<i>Elektroenergjetika dhe Menaxhimi i Energjisë, MSc 120 ECTS (A)</i>	Vezir Rexhepi Nora Sadiku Dushi

Me qëllim të vlerësimit të programeve të studimit, AKA ka organizuar vizitat me ekspertë ndërkombëtarë të akreditimit në Fakultetin e Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike në Universitetin e Prishtinës.

Bazuar në nenin 16 të Rregullores (AKA) Nr.03/2024 për procedurat e përzgjedhjes, angazhimit dhe kompensimit të ekspertëve të jashtëm dhe Rregulloren (AKA) Nr.04/2024 për Manualin e Akreditimit/Riakreditimit dhe Validimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe Programeve të Studimit në Nivelin Baçelor dhe Master (tutje Manualit), ekipi i vlerësuesve të jashtëm (Ekspertët ndërkombëtar) ka hartuar raportet e vlerësimit për këtë program dhe për fushat e standardeve të akreditimit të parapara në Manualin e Akreditimit ka dhënë konstatimet si në vijim:

Për programin e studimit; Elektroenergjetikë, BSc 180 ECTS (R) vizita me ekspertët ndërkombëtar të akreditimit është organizuar më 31.01.2025 me këtë përbërje: Francisco Javier Farfan, Faouzi Derbel, Issabek Muratov. Ekipi i ekspertëve ndërkombëtar ka konstatuar se : nga shtatë (7) fushat e standardeve të akreditimit ky program është vlerësuar se i përmbush:

- Plotësisht katër (4) fusha të standardeve të akreditimit;
- Substancialisht dy (2) fusha të standardeve të akreditimit;
- Pjesërisht një (1) fushë të standardeve të akreditimit.

Për programin e studimit; Elektroenergjetika dhe Menaxhimi i Energjisë, MSc 120 ECTS (A) vizita me ekspertët ndërkombëtar të akreditimit është organizuar më 31.01.2025 me këtë përbërje: Francisco Javier, Farfan, Faouzi Derbel dhe Issabek Muratov. Ekipi i ekspertëve ndërkombëtar ka konstatuar se : nga shtatë (7) fushat e standardeve të akreditimit ky program është vlerësuar se i përmbush:

- Plotësisht katër (4) fusha të standardeve të akreditimit;
- Substancialisht tri (3) fusha të standardeve të akreditimit;

Këshilli Shtetëror i Cilësisë, në mbledhjen e 137-të, të mbajtur më datë 19.05.2025, ka shqyrtuar dokumentacionin e Fakultetit të Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike në Universitetin e Prishtinës dhe duke u bazuar në raportet e ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit gjatë realizimit të vizitave si dhe rekomandimet përfundimtare të dhëna në raportet finale të vlerësimit nga ekspertët e cekur më sipër, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi pala e pa kënaqur mund të parashtroj ankesë në Komisionin e ankesave të AKA, sipas paragrafit 11 të nenit 22 të Ligjit nr. 08/l-110 për Agjencinë e Kosovës për Akreditim në afatin prej 30 ditëve nga dita kur pala është njoftuar për vendimin e KShC-së. Ankesa adresohet përmes organit publik që ka nxjerrë aktin.

Vendimi iu dërgohet:

- Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike në UP;
- MASHTI;
- Arkivit të AKA-së,


Prof. Asoc. Dr. Hasnija Hazi



Kryetare e Këshillit Shtetëror të Cilësisë